

011-1195/4300
07/10/2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDIM

Nr. 21 Datë 07/10/2024

MIRATIMI I MANUALIT PËR ZBATIMIN
E PROJEKTIT TË NDËRKOMBËTARIZIMIT

Bordi i Administrimit i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 126, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 80/2015, për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit vjetor Nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimit të Ministrit të Financave, Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i Projekteve në Universitetin e Arteve, pas diskutimeve dhe me votim të hapur,

VENDOSI

1. Miratimin e manualit për zbatimin e projektit të ndërkombëtarizimit (*manuali bashkangjitur vendimit*).
2. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Lavdrim SAHITAJ (Kryetar)

Ergis SEFA (Anëtar)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof. Asoc. Dr. Sokol SARACI (Anëtar)


Prof. Besnik BISHA (Anëtar)

Jeton SHEHU (Anëtar)

Lorenc VANGJELI (Anëtar)

Vladimir LLAKAJ (Anëtar)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
SEKTORI I PROJEKTEVE

Nr. 1135/1 Prot.

Tiranë, 20.09.2024

**Lënda: RELACION DHE MANUAL I PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË
NDËRKOMBËTARIZIMIT**

**THIRRJA PËR FINANCIMIN E IAL-EVE PUBLIKE, PËR PROJEKTET E PËRBASHKËTA
NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT.
URDHËR 360, DATË 28.06.2022, I MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT.**

PROF. DR. ERALD BAKALLI

REKTOR

I nderuar Z. Rektor,

Në kuadër të nisjes së zbatimit të projektit të përfutur përmes Thirrjes për financimin e IAL-eye Publike për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, të publikuar me Urdhër 360, dt 28.06.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe në kushtet e nevojës për përcaktimin e një liste me njësitë e kostove për realizimin e mobiliteteve të shkëmbimeve akademike të parashikuara në projektin e fituar nga ana e Universitetit të Arteve, do t'ju kërkonim vëmendjen për të përcjellë pranë Bordit të Administrimit Manualin e përgatitur për zbatimin e projektit të ndërkombëtarizimit, me qëllim shqyrtimin e tij si dhe përcaktimin e tarifave respektive.

Një përshkrim i shkurtër i procesit të ndërkombëtarizimit të studimeve në UART.

Universiteti i Arteve ka nisur që në vitin akademik 2016-2017 procesin e ndërkombëtarizimit të studimeve në fakultetet e tij përbërëse duke nënshkruar marrëveshje ndër-institucionale me dhjetëra institucione të arsimit të lartë të vendeve europiane si Spanja, Italia, Norvegjia e Gjermania në kuadër të Programit Erasmus+ KA1. Statistikisht numrat e mobiliteteve nga viti 2017 deri më tani janë si më poshtë:

- Personel akademik e administrativ UART jashtë vendit = 90
- Personel akademik dhe administrativ european në UART = 135
- Studentë shqiptarë UART në mobilitete semestrale studimi dhe internshipi = 62
- Studentë europianë në mobilitete semestrale studimi dhe internshipi në UART = 35



Të nisur nga këto të dhëna statistikore dhe të mbështetur në tendencat aktuale të ndërkombëtarizimit të studimeve, Universiteti i Arteve ka ndërmarrë një seri aktivitete për të arritur në nënshkrimin e marrëveshjeve ndër-institucionale në kuadër të programit Erasmus+ KA1, si dhe të marrëveshjeve për studime dhe diploma dypalëshe (me mentorë të dyfishtë) për të tre nivelet e studimeve: Bachelor, Master e Doktoraturë.

Marrëveshje bashkëpunimi për të finalizuar studime dhe diploma dypalëshe janë nënshkruar me:

- Conservatorio Superior de Musica de Vigo (Spanjë) – Bachelor + Master
- Accademia di Belle Arti Lecce - (Itali) Bachelor + Master
- Università degli Studi "Aldo Moro" Bari (Itali) – Bachelor + Master + Doktoraturë
- Università degli Studi Tor Vergata Roma (Itali) – PhD në Trashëgimi Kulturorë

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Me respekt



Prof. Pjetër Guralumi

Përgjegjës i Sektorit të Projekteve



MANUAL PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË NDËRKOMBËTARIZIMIT

THIRRJA PËR FINANCIMIN E IAL-EVE PUBLIKE, PËR PROJEKTET E PËRBASHKËTA NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT, URDHËR 360, DATË 28.06.2022, I MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT.

Fondi i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit është 10,973,760 Lekë
Masa e bashkëfinancimit është 20% e vlerës = 2,743, 440 Lekë
Totali i Projektit të Ndërkombëtarizimit = 13,717,200 Lekë

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi Kryesor:

Qëllimi kryesor i projektit të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit në Universitetin e Arteve është: të kontribuojë për zhvillimin, përmirësimin dhe përafrimin e kapaciteteve akademike të mësimit, për të tre ciklet e studimit dhe krijimin e mundësive për diplomat e përbashkëta, dypalëshe të studimeve universitare të versionit me mentorë të dyfishtë dhe njohjen e ndërsjellë të tyre në shtetet e origjinës së universiteteve respektive.

Neni 2 Objektivat specifikë

Objektivi specifik Nr.1: të rrisë kapacitetet akademike përmes ndërkombëtarizimit të mësimit si dhe të krijojë mundësitë e bashkëudhëqjeve të Diplomave Master në versionin me mentorë të dyfishtë midis institucioneve apo fakulteteve homologe

Neni 3

Aktivitetet e parashikuara për Objektivin Specifik 1

- OS 1.a) Vizita pune për rritjen e kapaciteteve akademike nga anëtarët e personelit akademik të secilit fakultet të UART në institucionet partnere.
- OS 1.b) Bursa disa mujore (jo më pak se 3) për studentët me rezultatet më të larta për përgatitjen e Diplomës së tyre Master "me mentorë të dyfishtë" pranë institucioneve partnere.
- OS 1.c) Vizita pune nga anëtarët e personelit akademik të huaj nga institucionet partnere për Fazën Përmbyllëse të Diplomave Master të tipit "me mentorë të dyfishtë".

Neni 4

Modalitetet e zbatimit të aktiviteteve të OS 1.a

- a) Vizita pune për rritjen e kapaciteteve akademike të personelit akademik shqiptar



o **Përzgjedhja:**

- o Kritere të përbashkëta për të gjithë UART
- o Vetëkandidim pranë Fakulteteve
- o Miratim nga një Komision ad-hoc ngritur nga Dekanatet respektive
- o Kostot e udhëtimit dhe të qëndrimit ditor në shtetet e BE përcaktohen me Vendim të Bordit të Administrimit të UART, sipas VKM-ve dhe Udhëzimeve në fuqi, por duke mos tejkaluar normat e Mobiliteteve Erasmus+.
- o Kohëzgjatja e udhëtimit – 5 ditë (përfshirë udhëtimin)
- o Numri i personelit akademik – 9 (3 për cdo fakultet të UART)
- o Modaliteti i pagesës: 80% parapagim, ndërsa diferenca prej 20%, pas dorëzimit të raportit narrativ të udhëtimit me dokumentacionin mbështetës. (boarding pass, i shtypur ose elektronik, agjenda e takimeve, material nga takimet dhe/ose produkte të vizitës, foto, vizibilitet të UART etj).

Neni 5

Modalitetet e zbatimit të aktiviteteve të OS 1.b

- b) Bursa 3 mujore për studentët Master “me mentorë të dyfishtë” pranë institucioneve partnere.

Përzgjedhja:

Nga nominimi deri në miratim merren parasysh hapat e mëposhtëm:

- o Kriteri i mesatares më të lartë të ponderuar, por jo më poshtë se 8.0
- o Kriteri i gjuhës zyrtare të institucionit pritës në nivelin B2, sipas niveleve dhe standarteve kombëtare të njohjes së gjuhëve të huaja.
- o Dokumentim i arritjeve artistike (audicion audio-video live, portfolio e studentit/es)
- o Miratim nga ana e palës partnere
- o 1 ECTS = 25 orë
- o Frekuentimi në prezencë
- o Kohëzgjatja e udhëtimit – 90 ditë (përfshirë udhëtimin)
- o Numri i studentëve – 6 (2 për cdo fakultet të UART)
- o Kostot e udhëtimit dhe të qëndrimit mujor në shtetet e BE përcaktohen me Vendim të Bordit të Administrimit të UART, sipas VKM-ve dhe Udhëzimeve në fuqi, por duke mos tejkaluar normat e Mobiliteteve Erasmus+.
- o Modaliteti i pagesës: 80% parapagim, ndërsa diferenca prej 20%, pas dorëzimit të raportit narrativ të udhëtimit me dokumentacionin mbështetës. (boarding pass, i shtypur ose elektronik, konfirmim i vizitës nga ana e institucionit pritës, raport i bashkë-udhëheqësit të temës së Diplomës të institucionit pritës, material nga takimet dhe/ose produkte të vizitës, foto, vizibilitet të UART etj).

Neni 6

Modalitetet e zbatimit të aktiviteteve të OS 1.c

- c) Vizita pune nga anëtarët e personelit akademik të huaj nga institucionet partnere për Fazën Përmblyëse të Diplomave Master të tipit “me mentorë të dyfishtë”.

o **Përzgjedhja:**

- o Përmes palës partnere përgjatë takimeve të ngritjes së kapaciteteve akademike të personelit akademik shqiptar në institucionet partnere
- o Në përputhje me programet e studimit prej nga ku janë përzgjedhur studentët shqiptarë
- o Njoftim zyrtar nga pala partnere



- o Kohëzgjatja e udhëtimit – 5 ditë (përfshirë udhëtimin)
- o Numri i personelit akademik të huaj – 6 (2 për çdo institucion partner)
- o Kostot e udhëtimit dhe të qëndrimit ditor të personelit akademik të huaj në Shqipëri përcaktohen me Vendim të Bordit të Administrimit të UART, sipas VKM-ve dhe Udhëzimeve në fuqi, por duke mos tejkaluar normativat e Mobiliteteve Erasmus+.
- o Modaliteti i pagesës: 80% parapagim, ndërsa diferenca prej 20%, pas dorëzimit të raportit narrativ të udhëtimit me dokumentacionin mbështetës. (boarding pass; i shtypur ose elektronik, agjenda e takimeve, material nga takimet dhe/ose produkte të vizitës, foto, vizibilitet të UART etj).

Neni 7

Objektivi specifik Nr.2

Të rrisë kapacitetet akademike përmes ndërkombëtarizimit të mësimdhënies si dhe të krijojë mundësitë e bashkëudhëqjeve të Doktoratave në versionin “me mentorë të dyfishtë” midis Fakulteteve të Universitetit të Arteve dhe institucioneve apo fakulteteve partnere.

Neni 8

Aktivitetet e parashikuara për Objektivin Specifik 2

- OS 2.a) Vizita pune për rritjen e kapaciteteve akademike nga anëtarët e personelit akademik të studimeve të Doktoratës pranë Fakulteteve të UART në institucionet partnere.
- OS 2.b) Bursa 3 mujore/vit (9 muaj total në 3 vite total) për doktorantët e pranuar nga të dy institucionet partnere të Studimeve të Ciklit të Tretë të Doktoratës e versionit “me mentorë të dyfishtë” për kërkime dhe punë studimore të drejtuar nga Udhëheqësit Shkencorë përkatës.
- OS 2.c) Vizita pune e Udhëheqësve Shkencorë nga institucionet partnere për Ciklin e Tretë të Studimeve Doktoraturë për bashkërendimin e studimeve dhe të Forumeve të Doktoratës së përbashkët të versionit “me mentorë të dyfishtë”.

Neni 9

Modalitetet e zbatimit të aktiviteteve të OS 2.a

- a) Vizita pune për rritjen e kapaciteteve akademike nga anëtarët e personelit akademik të studimeve të Doktoratës pranë Fakulteteve të UART në institucionet partnere.
- o **Përzgjedhja:**
 - o Kriteria të përbashkëta për të gjithë Fakultetet e UART
 - o Vetëkandidim i Udhëheqësve Shkencorë sipas listave të miratuara dhe të shpallura me kriteret e Studimeve të Ciklit të Tretë
 - o Miratim nga një Komision ad-hoc ngritur nga Dekanatet respektive
 - o Kostot e udhëtimit dhe të qëndrimit ditor në shtetet e BE përcaktohen me Vendim të Bordit të Administrimit të UART, sipas VKM-ve dhe Udhëzimeve në fuqi, por duke mos tejkaluar normativat e Mobiliteteve Erasmus+.
 - o Kohëzgjatja e udhëtimit – 5 ditë (përfshirë udhëtimin)
 - o Numri i personelit akademik të parashikuar – 6 (2 për çdo fakultet të UART)
 - o Modaliteti i pagesës: 80% parapagim, ndërsa diferenca prej 20%, pas dorëzimit të raportit narrativ të udhëtimit me dokumentacionin mbështetës. (boarding pass

shtypur ose elektronik, agjenda e takimeve, material nga takimet dhe/ose produkte të vizitës, foto, vizibilitet të UART etj).

Neni 10

Modalitetet e zbatimit të aktiviteteve të OS 2.b

- b) Bursa 3 mujore/vit (9 muaj total në 3 vite total) për doktorantët e pranuar nga të dy institucionet partnere të Studimeve të Ciklit të Tretë të Doktoratës e versionit “me mentorë të dyfishtë” për kërkime dhe punë studimore të drejtuar nga Udhëheqësit Shkencorë përkatës.
- Konfirm i periudhës studimore kërkimore nga ana e Udhëheqësit Shkencor të institucionit partner.
 - Kohëzgjatja e udhëtimit – 60 ditë (përfshirë udhëtimin) në vit.
 - 1 ECTS = 25 orë
 - Frekuentimi në prezencë dhe hibrid
 - Numri i doktorantëve të parashikuar – 6 (2 për çdo fakultet të UART).
 - Kostot e udhëtimit dhe të qëndrimit ditor/mujor në shtetet e BE përcaktohen me Vendim të Bordit të Administrimit të UART, sipas VKM-ve dhe Udhëzimeve në fuqi, por duke mos tejkaluar normativat e Mobiliteteve Erasmus+.
 - Modaliteti i pagesës: 80% parapagim, ndërsa diferenca prej 20%, pas dorëzimit të raportit narrativ të udhëtimit me dokumentacionin mbështetës. (boarding pass, i shtypur ose elektronik, konfirmim i vizitës nga ana e institucionit pritës, raport i veprimtarisë së zhvilluar bashkëfirmosur nga ana e udhëheqësit të temës së Diplomës të institucionit pritës, material nga takimet dhe/ose produkte të vizitës, foto, vizibilitet të UART etj).

Neni 11

Modalitetet e zbatimit të aktiviteteve të OS 2.c

- c) Vizita pune e Udhëheqësve Shkencorë nga institucionet partnere për Ciklin e Tretë të Studimeve Doktoraturë për bashkërendimin e studimeve dhe të Forumeve të Doktoratës së përbashkët të versionit “me mentorë të dyfishtë”.
- o Njoftim zyrtar nga pala e personelit akademik të huaj partnere.
 - o Kohëzgjatja e udhëtimit – 5 ditë (përfshirë udhëtimin).
 - o Numri i udhëheqësve shkencorë të parashikuar – 6 (sipas numrit të doktorantëve)
 - o Kostot e udhëtimit dhe të qëndrimit ditor të personelit akademik të huaj në Shqipëri përcaktohen me Vendim të Bordit të Administrimit të UART, sipas VKM-ve dhe Udhëzimeve në fuqi, por duke mos tejkaluar normativat e Mobiliteteve Erasmus+.
 - o Modaliteti i pagesës: 80% parapagim, ndërsa diferenca prej 20%, pas dorëzimit të raportit narrativ të udhëtimit me dokumentacionin mbështetës. (boarding pass, duke përfshirë edhe ato elektronike, agjenda e takimeve, material nga takimet dhe/ose produkte të vizitës, foto, vizibilitet të UART etj).

Neni 12

Objektivi specifik Nr.3



Të krijohet kushtet për reformimin e ofertës akademike në UART, për t'ia përshtatur atë sa më shumë zhvillimeve ndërkombëtarizuese në kontekstin e perspektivave të zhvillimit afatmesëm e afatgjatë të Arsimit të Lartë kundrejt nevojave të tregut të punës në fushën e arteve, kulturës dhe edukimit artistik mbarëkombëtar.

Neni 13

Aktivitetet e parashikuara për Objektivin specifik 3

- OS 3.a) Vizita pune në 3 institucione partnere për reformimin e ofertës akademike në UART, për t'ia përshtatur atë në mënyrë sa më koherente zhvillimeve aktuale ndërkombëtarizuese të Arsimit të Lartë. Pjesëmarrje e personelit akademik dhe administrativ.
- OS 3.b) Vizita pune nga personel akademik dhe/ose administrativ nga të 3 institucionet partnere për reformimin e ofertës akademike në UART.

Neni 14

Modalitetet e zbatimit të aktiviteteve të OS 3.a

- a) Vizita pune në 3 institucione partnere për reformimin e ofertës akademike në UART, për t'ia përshtatur atë në mënyrë sa më koherente zhvillimeve aktuale ndërkombëtarizuese të Arsimit të Lartë. Pjesëmarrje e personelit akademik dhe administrativ.
- o **Përzgjedhja:**
 - o Krite të përbashkëta për të gjithë UART
 - o Vetëkandidim pranë Fakulteteve për personelin akademik
 - o Vetëkandidim pranë Administratorit të UART për personelin administrativ
 - o Miratim nga një Komision ad-hoc propozuar nga Rektori.
 - o Ftesa dhe miratimi i datave nga institucioni partner.
 - o Kostot e udhëtimit dhe e qëndrimit ditor në shtetet e BE zbatohen sipas përcaktimeve të VKM dhe Udhëzimeve në fuqi, por duke mos tejkaluar normativat e Mobiliteteve Erasmus+, të paraqitura si më poshtë:
 - o Kohëzgjatja e çdo vizite – 5 ditë (përfshirë udhëtimin)
 - o Numri i vizitave - 3 (nga një për secilin institucion partner)
 - o Numri i personelit akademik të parashikuar – 3 (për çdo fakultet të UART)
 - o Numri i personelit administrativ të parashikuar – 3 (sipas modaliteteve të përcaktuara në rektoratin e UART)
 - o Kostot e udhëtimit dhe të qëndrimit ditor në shtetet e BE përcaktohen me Vendim të Bordit të Administrimit të UART, sipas VKM-ve dhe Udhëzimeve në fuqi, por duke mos tejkaluar normativat e Mobiliteteve Erasmus+.
 - o Modaliteti i pagesës: 80% parapagim, ndërsa diferenca prej 20%, pas dorëzimit të raportit narrativ të udhëtimit me dokumentacionin mbështetës. (boarding pass, i shtypur ose elektronik, agjenda e takimeve, material nga takimet dhe/ose produkte të vizitës, foto, vizibilitet të UART etj).

Neni 15

Modalitetet e zbatimit të aktiviteteve të OS 3.b

- b) Vizita pune nga personel akademik dhe/ose administrativ nga të 3 institucionet partnere për reformimin e ofertës akademike në UART.
- o Konfirmimi i datave të vizitës nga institucioni partner.




- o Kohëzgjatja e cdo vizite – 5 ditë (përfshirë udhëtimin)
- o Kostot e udhëtimit dhe të qëndrimit ditor të personelit akademik të huaj në Shqipëri përcaktohen me Vendim të Bordit të Administrimit të UART, sipas VKM-ve dhe Udhëzimeve në fuqi, por duke mos tejkaluar normativat e Mobiliteteve Erasmus+.
- o Modaliteti i pagesës: 80% parapagim, ndërsa diferenca prej 20%, pas dorëzimit të raportit narrativ të udhëtimit me dokumentacionin mbështetës. (boarding pass, i shtypur ose elektronik, agjenda e takimeve, material nga takimet dhe/ose produkte të vizitës, foto, vizibilitet të UART etj).

Neni 16 Koordinimi

- a) Grupi i punës së Universitetit të Arteve lidhur me propozimin dhe zbatimin e projektit mbi Thirrjen për financimin e IAL-eve Publike, për projektet e përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, Urdhër 360, datë 28.06.2022 i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ngarkon një koordinator (brenda grupit), i cili organizon dhe realizon procedurat mbi objektivat specifike të projektit.
- b) Koordinatorin e këtij projekti përgatit dokumentacionin mbështetës për shpenzimet e kryera nga përfituesit e fondit të aprovuar nga MAS.

Shënime:

- Thirrjet për pjesëmarrje për personel akademik, administrativ, studentë do të bëhen publike sipas kalendareve të cilat do të koordinohen midis Universitetit të Arteve dhe Institucioneve Partnere.
- Rregulloret e Studimeve, Format e vlerësimit të përbashkët, Praktikat profesionale dhe lehtësimi i procedurave të ndërsjellëta, Ngritja e komisioneve për diplomimet e përbashkëta, Realizimi i procedurës së diplomimit të studentëve me diploma të dyfishta do të jenë pjesë e produkteve dokumentacionale për institucionalizimin e diplomimeve të dyfishta të versionit "me mentorë të dyfishtë" të Universitetit të Arteve me institucionet partnere europiane.

Përgatiti

 Prof. Pjetër Guralumi
 Përgjegjës i Sektorit të Projekteve



PROJEKSIONE TË SHPENZIMEVE FINANCIARE

Zërat e shpenzimeve	Sipas Legjislacionit Shqiptar në fuqi	Sipas standarteve të Programit ERASMUS+		
		Deri 500 km	Deri 1999 km	Mbi 1999 km
Udhëtim ndërkombëtar	Blerje dinamike	180 Euro	275 Euro	360 Euro
Kosto Qendrimi ditore personel akademik ose administrativ Shqiptar (hotel + dietë ditore ushqim)	Sipas faturës së hotelit + dieta ditore për ushqim)	120 Euro/ditë		
Kosto Qendrimi ditore personel akademik ose administrativ Evropian (hotel + dietë ditore ushqim)	Sipas faturës së hotelit + dieta ditore për ushqim)	180 Euro/ditë		
Kosto qendrimi mujore student Bachelor dhe Master (30 ditë hotel + 30 ditë ushqim)	Sipas faturës së hotelit + dieta ditore për ushqim / 30 ditë)	850 Euro/muaj		
Kosto qendrimi Student Doktorature (30 ditë hotel + 30 ditë ushqim)	Sipas faturës së hotelit + dieta ditore për ushqim / 30 ditë)	1800 Euro/muaj 15 ditët e para = 70 Euro/ditë = 1050 Euro 15 ditët e dyta = 50 Euro/ditë = 750 Euro		

